



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2026

Lënda: Kërkesë për informacion.

Drejtuar: **Z. Bajram BEGAJ**
President i Republikës së Shqipërisë

Tiranë

Zoti President,

Në ushtrim të funksionit të kontrollit parlamentar dhe në interes të transparencës institucionale lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive kushtetuese në fushën e sigurisë kombëtare, në mbështetje të nenit 8, të Ligjit Nr. 8550, datë 18.11.1999 “*Statusi i Deputetit*”, i ndryshuar, kërkojmë një informacion të plotë dhe të dokumentuar mbi mënyrën se si është shqyrtuar dhe verifikuar kandidatura e shtetases Vlora Hyseni përpara dekretimit të saj, si dhe informacionet që kanë qenë në dispozicion të Presidentit gjatë ushtrimit të detyrës dhe në momentin e shkarkimit të saj.

Kërkesa mban në konsideratë faktin se, sipas kuadrit ligjor në fuqi, Drejtori i SHISH emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit. Për këto arsye, është e nevojshme që Kuvendi i Shqipërisë të njihet me mënyrën se si është ushtruar përgjegjësia institucionale e Presidentit të Republikës në fazën e emërimit, ushtrimit të detyrës dhe shkarkimit të ish-Drejtorit të SHISH, Vlora Hyseni.

I. Lidhur me marrjen dhe shqyrtimin e propozimit

1. Në çfarë date i është paraqitur Presidentit propozimi i Kryeministrit për emërimin e shtetases Vlora Hyseni?
2. Çfarë dokumentacioni ka shoqëruar propozimin?
3. A ka përfshirë dokumentacioni CV-në e plotë dhe historikun profesional të kandidates?
4. A ka përfshirë informacion mbi veprimtarinë e saj të mëparshme në institucionet e sigurisë së Republikës së Kosovës?
5. A ka përfshirë informacion mbi rrethanat e largimit të saj nga detyrat e mëparshme?
6. A ka përfshirë dokumentacion mbi verifikimet e sigurisë?
7. A ka përfshirë referenca nga shërbimet partnere?
8. A ka përfshirë informacion nga autoritetet e Republikës së Kosovës?
9. A ka kërkuar Presidenti informacion apo dokumentacion shtesë nga Kryeministri?
10. Nëse po, cilat informacione dhe dokumente?

11. A ka kërkuar Presidenti informacion nga SHISH?
12. A ka kërkuar informacion nga institucionet ligjzbatuese?
13. A ka kërkuar informacion nga SPAK?
14. A ka kërkuar informacion nga Prokuroria e Përgjithshme?
15. A ka kërkuar informacion nga Policia e Shtetit, AMP, AKSIK ose institucione të tjera?

II. Lidhur me informacionet e administruara nga Republika e Kosovës

16. A ka kërkuar Presidenti informacion nga autoritetet e Republikës së Kosovës lidhur me shtetasen Hyseni?
17. A është kontaktuar Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI)?
18. A është kërkuar informacion mbi periudhën e saj të shërbimit?
19. A është kërkuar informacion mbi arsyet e largimit të saj nga detyra?
20. A është kërkuar informacion mbi verifikime të mëparshme të sigurisë?
21. A është kërkuar informacion mbi procedime administrative, disiplinore, penale ose hetimore?
22. A është kërkuar informacion mbi kontakte të mundshme me persona që paraqisnin risk sigurie?
23. Kur janë marrë përgjigjet nga autoritetet kosovare?
24. Çfarë konkluzionesh përmbanin ato?
25. A kanë pasur ndonjë rezervë, paralajmërim apo informacion që kërkonte verifikim të mëtejshëm?
26. A janë administruar këto përgjigje në dosjen e kandidaturës së propozuar?

III. Lidhur me informacionet e administruara nga partnerët ndërkombëtarë

27. A ka marrë Presidenti referenca nga shërbimet partnere lidhur me shtetasen Hyseni?
28. Nëse po, cilat institucione kanë dhënë këto referenca?
29. Në çfarë date janë marrë?
30. A kanë qenë me shkrim?
31. A kanë pasur këto referenca ndonjë rezervë ose kufizim?
32. A ka kërkuar Presidenti verifikim të mëtejshëm të tyre?
33. A ka marrë Presidenti informacion nga NATO ose strukturat e saj?
34. A ka marrë informacion mbi besueshmërinë e shtetasës Hyseni për administrimin e informacionit të klasifikuar?
35. A ka pasur ndonjë paralajmërim ose shqetësim nga partnerët ndërkombëtarë?

IV. Lidhur me informacionet e administruara gjatë ushtrimit të detyrës

36. Sa raporte zyrtare ka marrë Presidenti nga Drejtori i SHISH gjatë mandatit të shtetasës Hyseni?
37. Sa prej tyre kanë qenë raporte periodike dhe sa raporte të posaçme?
38. A ka raportuar ndonjëherë Drejtori i SHISH mbi incidente të sigurisë së informacionit?
39. A ka raportuar mbi rrjedhje të mundshme të informacionit të klasifikuar?
40. A ka raportuar mbi kontakte të personelit të SHISH me persona të paautorizuar?
41. A ka pasur ndonjë raport që lidhej drejtpërdrejt ose indirekt me shtetasen Hyseni?

42. A ka marrë Presidenti ndonjë informacion nga SPAK gjatë mandatit të saj?
43. A ka marrë ndonjë informacion nga partnerët ndërkombëtarë?
44. A ka marrë ndonjë informacion nga autoritetet e Kosovës?
45. A ka marrë ndonjë informacion lidhur me shtetasin Ergys Agasi dhe marrëdhëniet e tij me shtetasen Hyseni?
46. A ka kërkuar Presidenti ndonjëherë sqarim nga Drejtori i SHISH lidhur me këto çështje?
47. A ka kërkuar Presidenti ndonjëherë një verifikim të posaçëm lidhur me akuzat e ngritura ndaj shtetases Vlora Hyseni nga opozita parlamentare dhe mediat?

V. *Lidhur me komunikimet institucionale me Kryeministrin*

48. Sa herë është konsultuar Presidenti me Kryeministrin lidhur me veprimtarinë e shtetases Hyseni?
49. A ka pasur komunikime të posaçme mbi integritetin ose besueshmërinë e saj?
50. A ka kërkuar Presidenti informacione shtesë nga Kryeministri?
51. A ka marrë nga Kryeministri informacion lidhur me kontaktet e shtetases Vlora Hyseni me shtetasin Ergys Agasi?
52. A ka marrë informacion nga Kryeministri lidhur me hetime ose verifikime të mundshme?
53. A ka diskutuar me Kryeministrin mbi informacionet e marra nga autoritetet e Kosovës?
54. A ka diskutuar me Kryeministrin mbi informacionet e partnerëve ndërkombëtarë?

VI. *Lidhur me shkarkimin nga detyra të shtetases Vlora Hyseni*

55. Në çfarë date i është paraqitur Presidentit propozimi për shkarkimin e znj. Hyseni?
56. Çfarë dokumentacioni shoqëronte propozimin?
57. A përmbante propozimi informacion mbi masat e sigurisë ndaj saj?
58. A përmbante informacion nga SPAK?
59. A përmbante informacion mbi hetimin penal?
60. A përmbante informacion mbi ndonjë komprometim të mundshëm të informacionit të klasifikuar?
61. A kërkoj Presidenti informacion shtesë përpara dekretimit të shkarkimit?
62. A u konsultua Presidenti paraprakisht me Kryeministrin?
63. A u konsultua Presidenti me institucione të tjera të sigurisë?
64. A u kërkuar ndonjë informacion nga SPAK ose Prokuroria?
65. A u konsultuan partnerët ndërkombëtarë?
66. A u verifikua nëse shtetasja Hyseni kishte informuar më parë Kryeministrin ose Presidentin për ekzistencën e ndonjë hetimi?
67. A u verifikua nëse ajo kishte deklaruar më parë ekzistencën e kontakteve me shtetasin Ergys Agasi?
68. A u krye ndonjë vlerësim mbi pasojat e mundshme për sigurinë kombëtare?

Krahas informacionit të mësipërm, kërkohet vënia në dispozicion e një kopje të njëhsuar me origjinalin të dokumentacionit si më poshtë vijon:

1. Propozimi i Kryeministrit për emërimin e shtetases Vlora Hyseni;
2. Relacionet dhe materialet shoqëruese të propozimit;
3. Dosja e shqyrtimit të kandidaturës;
4. Korrespondenca me Kryeministrinë;
5. Korrespondenca me autoritetet e Republikës së Kosovës;
6. Korrespondenca me shërbimet partnere;
7. Çdo informacion i administruar nga NATO ose strukturat përkatëse;
8. Përgjigjet e institucioneve shqiptare të kontaktuara;
9. Çdo informacion i administruar nga SPAK, Prokuroria e Përgjithshme, Policia e Shtetit, AMP, AKSIK apo institucione të tjera ligjzbatuese;
10. Çdo vlerësim apo raport sigurie mbi kandidaturën;
11. Propozimi i Kryeministrit për shkarkimin e shtetases Vlora Hyseni;
12. Praktika shkresore që shoqëroi propozimin për shkarkim;
13. Korrespondenca dhe konsultimet institucionale të zhvilluara përpara dekretimit të shkarkimit;
14. Çdo analizë, raport, relacion, memorie, opinion mbi pasojat për sigurinë kombëtare;
15. Çdo dokument që lidhet me masat e marra për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

Sjellim në vëmendjen tuaj se deputeti kërkues, në cilësinë e Zëvendëskryetarit të Komisionit për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes, është i pajisur me Certifikatën e Sigurisë së Personelit (CSP) nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), çka i mundëson akses të plotë edhe në informacion të klasifikuar “*sekret shtetëror*”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

D E P U T E T I

Klevis BALLIU